



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:269973  
Datë: 21.02.2025  
Numri i dokumentit: 06878800

**C-IV-14-6667**

*Ushtruesit e kërkesës*

**M J, R J, T J, Xh S, S R, M S, R K, M R, A R, Z F, E H, S K që të gjithë nga Gjilani**, të cilët me autorizim i përfaqëson **E Q**, avokat nga Gjilani.

*Kundër*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit** (NSH “Integj”), Rr.Dritan Hoxha nr.55 Lakrishtë Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare te Privatizimit (DHPGJS) gjyqtarja Hajrie Shala me date 14 shkurt 2025 lëshon këtë:

**AKTVENDIM**

**1.** Kërkesa për rishikimin e vendimit të AL-së nr. GJI085-4730 e ushtruar nga **M J, R J, T J, Xh S, S R, M S, R K, M R, A R, Z F, E H, S K**, hudhet posht; si e papranueshme .

**2.** Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesit.

## **Rrethanat procedurale**

Me 21 tetor 2014, ankuesit përmes të autorizuarit të tyre kanë parashtruar kërkesë për rishikim të vendimit në DHPGJS kundër vendimit të AL-së me numër GJI085-4730, ku ankuesit M J, Xh S, S R, M R, A R e E H meqenëse kanë qenë në marrdhënje pune tek NSH “Integj”, pranë AL-së kanë paraqitur kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara, ndërsa ankuesit T J, Z F, R K, S K, R J e M S pranë AL-së kanë paraqitur kërkesë për kompensimin e detyrimeve që i ka pasur NSH-ja ndaj tyre në bazë të kontratës të datës 29 dhjetor 1988, mbi bashkimin e punës dhe mjeteve. Me që rast në kërkesën e parashtruar kanë theksuar se të njejtëve për shkak të masave të dhunshme të organeve të Republikës së Serbisë i është ndërprerë marrdhënja e punës si dhe i është refuzuar përmbushja e detyrimit sipas kontratave, duke shtuar se të njejtit kanë paraqitur ankesa në Gjykatë në periudhën e okupimit prej vitit 1990-1999 mirëpo, organet e asaj kohe nuk kanë vendosur për kërkesat e komunitetit shqiptar dhe se pas tërheqjes të njejtat organe i kanë larguar edhe lëndët andaj, ato lëndë nuk gjinden në gjykatat e Kosovës, mirëpo disa prej ankuesve kanë ndonjë kopje të dokumentave të dorëzuar në gjykatë në atë kohë. Tutje kanë shtuar se vendimi i autoritetit të likuidimit është i gabuar pasi është zbatuar gabimisht e drejta material për faktin se në këtë çështje sipas të autorizuarit të ankuesve nuk ka ardhur deri te parashkrimi i kërkesës pasi afati i parashkrimit është ndërprerë me veprimet e ankuesve që nga viti 1990 e deri 1995 e të cilët kanë qenë të detyruar që përsëri të paraqesin padi. Andaj, kanë kërkuar nga gjykata që të priset vendimi i AL-së dhe ankuesve tu përmbushen kontratat e lidhura me 29 dhjetor 1988, të njejtëve tu kthehen mjetet e punës secilit vec e vec sipas kontratës si dhe tu bëhet pagesa në pajtim me Ligjin për AKP-në. Në mbështetje të ankeses ka paraqitur provat: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Padinë e datës 23 mars 1995, Ankesën e datës 24 dhjetor 1996, Ankesën me numër C.nr.410/90, Kontratën mbi rregullimin e obligimeve reciproke e datës 29.12.1988 e lidhur mes NSH-së dhe F K, Kontratën mbi bashkimin e punës dhe mjeteve e datës 24.12.1988 e lidhur mes NSH-së dhe Sh H dhe S K, Kontratën mbi Bashkimin e Punës dhe Mjeteve e datës 19 dhjetor 1988 e lidhur në mes të NSH-së dhe Sh F, Kontratën mbi Bashkimin e Punës dhe Mjeteve e datës 19 dhjetor 1988 e lidhur në mes të NSH-së dhe M J dhe R J, Kontratën mbi Bashkimin e Punës dhe Mjeteve e datës 19 dhjetor 1988 e lidhur në mes të NSH-së dhe F R, T J dhe Xh S, Kontratë mbi rregullimin e obligimeve reciproke e datës 19 dhjetor 1988 dhe T J dhe Xh S, dhe , Kontratën mbi Bashkimin e Punës dhe Mjeteve e datës 19 dhjetor 1988 e lidhur në mes të NSH-së dhe S R e M S, Vendimin e datës 10 tetor 1990.

Më datë 22 prill 2024, gjykata ka lëshuar urdhër me të cilin ka kërkuar nga i autorizuari i ankuesve që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njejtit të dorëzoj në gjykatë si prova kopjen e njoftimit lidhur me ndërprerjen e marrdhënjës së punës me emër dhe me mbiemër të secilit, kopjen e librezave të punës, kopjen e listës së pagave si dhe prova të tjera shtesë.

I autorizuari i ankuesve të njejtin urdhër e ka pranuar me datë 25 prill 2024 mirëpo, të njejtit nuk i është përgjigjur deri në marrjen e këtij aktvendimi.

Dhoma e Posaçme ia dërgoi AKP-së kërkesën për rishqyrtim të vendimit të AL-së dhe e njëjta më datë 11 korrik 2024 në përgjigje deklaroi se qëndrojnë mbrapa vendimit të autoritetit të likuidimit dhe se i njëjti nuk ka shkelje ligjore, duke shtuar se kërkesa është paraqitur jashta afatit për paraqitje të kërkesave mirëpo, edhe nëse e njëjta do të paraqitej brenda afatit e njëjta është e parashkruar pasi në bazë të nenin 371 të Ligjit Mbi Kontratat dhe Detyrimet ( publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 29/1978), në afatin e përgjithshëm të parashkrimit parashihet se “kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”, andaj edhe kanë kërkuar nga ana e gjykatës që e njëjta ankesë të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

### **Arsyetim ligjor**

Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjykata vërtetoi se Ndërmarrja Shoqërore NSH “Integj” është privatizuar dhe e njëjta ka nxjerr njoftimet për fillimin e likuidimit me datë 16 nëntor 2006 dhe këto njoftime u publikuan në gazetën serbe “Blic” dhe gazetën “Koha Ditore” dhe “Zëri” me datë 07 dhjetor 2006 dhe 12 dhjetor 2006, e që afati për paraqitje të kërkesave ishte deri me datë 12 shkurt 2007, kurse ankuesit kërkesën e kishin paraqitur me datë 24 korrik 2012, e që është jashta afatit për dorëzimin e kërkesave. Ndërsa, parashtruesit e ankesës kanë ushtruar ankesën e parë pranë DHPGJ-së me datë 13 tetor 2005 ndërsa, ankesën e dytë që është objekt shqyrtimi me datë 21 tetor 2014 e që janë pas afatit kohor.

Edhe AKP-ja në mbrojtjen e saj pretendon se ankesa është parashtruar pas afatit kohor dhe si e tillë duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Procedura e paraqitjes së ankesës për këtë çështje juridike duhet të paraqitej në afat prej 5 vjetësh e që përcaktohet me nenin 371 të Ligjit Mbi Kontratat dhe Detyrimet ( publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 29/1978).

Përcaktimi i afateve ligjore nga ligjvënësi brenda të cilit duhet ndërmarrë një veprim bëhet me qëllim të zhvillimit të një procedure më të shpejtë dhe më të drejtë, që janë parime të përgjithshme për të gjitha procedurat gjyqësore në të kundërtën do të cenonte sigurinë juridike.

Andaj nga sa u tha më lartë Gjykata gjeti se në kuptim të nenit 36 pika 2.4 I DHPGJS-së ankesa duhet hedhur poshtë si e pa pranueshme.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e  
**Hajrie Shala**